



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KESHILLI BASHKIAK

Njoftim për konsultim publik

Titulli i Projekt-aktit : “Plani i Përmirësimit të Arsimit Parashkollor 2025-2027”

Propozuesi: Mariglen Disha, Kryetari i Bashkisë

Sqarime për projekt-aktin:

Kalendari i konsultimit : Konsultimi publik do të realizohet sipas kalendarit të konsultimeve.

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Menyra	Forma
1	Konsultim publik me Keshillat e Prinderve, Bordet e Prinderve te te gjithë kopshteve te Bashkise Librazhd, perfaqesues te komunitetit, grupet vulnerabel, OJF, Biznese, etj.	10 dhjetor 2024	Salla e mbledhjeve, Qendra e Kultures, Librazhd	12:00	Takim publik	Diskutim

Pjesëmarrës :

- **Nga ana e Bashkisë:** Mitat Biçaku, Kryetar i Keshillit Bashkiak Librazhd (KB), Fatbardha Qatja, Kryetare e Komisionit të Arsimit, Kultures, Sportit, Shendetsise dhe Çeshtjeve Sociale, KB, Anetaret e Komisionit të Arsimit, Kultures, Sportit, Shendetsise dhe Çeshtjeve Sociale, KB, Ermir Sulollari, NenKryetar i Bashkise Librazhd, Nadire Biçaku, Drejtore e Burimeve Njerezore, Bashkia Librazhd, Albana Hoxha, Drejtore e Finance/Buxhetit Bashkia Librazhd, Marsida Çota, Specialiste e Sektorit të Arsimit, Kultures, Rinise, Sportit dhe Organizimit të Aktiviteteve Festive, Bashkia Librazhd, Drejtoret dhe Mesueset e Lopshteve ne Bashkine Librazhd, Zyetare te ZVAP Librazhd, Perfaqesues te Institucioneve mbeshtetese te Arsimit Parshkollor Librazhd, etj.
- **Nga komuniteti:** Këshillat e Prindërve, Bordet e Kopshteve, përfaqësues nga bizneset, përfaqësues nga shoqëria civile, përfaqësues te grupeve vulnerabel - Romë dhe Egjiptianë dhe persona me aftesi te kufizuar, qyetare te Bashkise Librazhd.

Format e konsultimit: Tryeza diskutimi/Takime publike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KESHILLI BASHKIAK

<p>Qëllimi i konsultimit publik</p>	<p><i>Këshilli i Bashkisë në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” i ndryshuar si dhe në zbatim të rregullores së Këshillit ka për qëllim të garantojë pjesmarrjen e komunitetit në vendimarrje si dhe të organizojë konsultime publike duke marrë parasysh mendimin e komunitetit përgjatë procesit të konsultimit duke i përfshirë ato në draftin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë.</i></p> <p><i>Plani i Përmirësimit të Shërbimit të Arsimit Parashkollor prek të gjithë familjet, fëmijët e të cilave frekuentojnë kopshtet në territorin e bashkisë Elbasan si dhe gjithë fëmijët në moshë kopshti që potencialisht mund të jenë frekuentues të këtyre kopshteve, pasi kopshti i fëmijëve është themeli i rrugëtimit arsimor të një fëmije, duke ofruar përfitime gjatë gjithë jetës përtej viteve të hershme.</i></p> <p><i>Duke njohur rëndësinë e arsimit parashkollor/kopshtit dhe duke investuar në aksesin dhe cilësinë e tij, për të siguruar një të ardhme më të ndritshme për fëmijët dhe shoqërinë e tij. Këshilli i Bashkisë, si përfaqësues i komunitetit, kërkon të marrë më shumë informacion për ndikimin dhe efektet që ky vendim mund të ketë në komunitetin e Bashkisë, nëse ky projekt-vendim i shërben përmirësimit të jetës së komunitetit, nëse ai i shërben interesit publik si dhe nëse ai duhet miratuar siç është paraqitur, apo duhet të miratohet i përmirësuar.</i></p>
<p>Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti</p>	<p><i>Në vitin 2015, gjatë periudhës së ndryshimeve politike në Shqipëri, u ndërmorën reforma të rëndësishme që preknin strukturën e bashkive në vend. Këto ndryshime organizative sollën krijimin e 61 bashkive të reja, duke sjellë me vete sfida të shumta administrative dhe organizative. Transformimet u realizuan në përpjekje për të decentralizuar më tej pushtetin lokal dhe për t’ju përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqënie sociale dhe ekonomike në nivel lokal.</i></p> <p><i>Në lidhje me arsimin parashkollor, Bashkia Librazhd mori përsipër përgjegjësinë për zbatimin dhe përmirësimin e këtij shërbimi në territorin e saj. Pas një eksperience pune tetë vjeçare në ofrimin e shërbimit të Arsimit Parashkollor, tashmë duke njohur mirë nevojat dhe sfidat Bashkia Librazhd, ka punuar për një plan të qartë afat-mesëm (2025-2027) për përmirësimin në vijim të shërbimit për të adresuar nevojat dhe sfidat në kopshte. Plani i Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor i propozuar është i bazuar në analizën e diagnozës së shërbimit nëpërmjet pyetësorëve dhe analizën e legjislacionit përkatës për Arsimin Parashkollor. Në analizë janë marrë edhe planet e tjera të</i></p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KESHILLI BASHKIAK

	<p><i>Bashkisë duke i gërshetuar nevojat në mënyrë që vendimarrja të jetë sa më gjithëpërfshirëse. Plani i Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Librazhd përqendrohet në <u>Proceset e Menaxhimit të shërbimit në arsimin parashkollor</u>, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe organizimit efektiv. Plani i Përmirësimit të Shërbimit synon të adresojë <u>Proceset Kryesore</u> dhe të përmirësojë shërbimin për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe ata me aftësi të kufizuara në kopshtet publike të Bashkisë Librazhd. Planifikimi dhe zbatimi i <u>Proceseve Mbështetëse</u> në Planin e Përmirësimit të Shërbimit për kopshtet publike të Bashkisë Librazhd është një pjesë kritike e përpjekjeve për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe cilësor për fëmijët. Qëllimi i <u>Proceseve Mbështetëse</u> është të sigurojë mbështetje efektive për <u>Proceset Kryesore të Shërbimit në kopshte</u>. Këto përfshijnë aspekte të rëndësishme si edukimi, siguria, zhvillimi dhe aksesueshmëria për të gjithë fëmijët.</i></p>
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	<ol style="list-style-type: none"><i>1. Si e gjykoni situatën apo gjendjen e kopshteve në teritorin e Bashkisë Librazhd, si është situata në kopshtin ku ju çoni fëmijën tuaj?</i><i>2. A mendoni se plani dhe objektivat e tij i përmbushin pritshmeritë tuaja në lidhje me përmirësimin e cilësisë së kushtve në kopshte?</i><i>3. Ç'farë sugjerimesh do të kishit ju, sugjerime të cilat nuk janë përfshirë në dokumentat e këtij projekt-akti, në mënyrë që situata në kopshte të ndryshojë vit pas viti në të mirë të fëmijëve tanë dhe komunitetit?</i>
Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktin për këshillim	<p><i>Këshilli Bashkiak nëpërmjet Komisionit të Arsimit, Kultures, Sportit, Shëndetsisë dhe Çeshtjeve Sociale ben publik kalendarin e konsultimeve (si me lart). Administrata e bashkise do të lehtësojë komunikimin me qytetarët e interesuar dhe përfaqësues të prindërve.</i></p> <p><i>Do të vihet në dispozicion një adresë e-mail ku do të dërgohen rekomandimet e qytetarëve.</i></p>
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve	<p><i>Kontaktet ku do të dërgohen rekomandimet janë:</i></p> <p><i>Sekretari i Keshillit Bashkiak:</i> <i>Elson Malluta, email: elson.malluta25@gmail.com</i></p> <p><i>Spektori i Arsimit, Kultures, Rinise, Sportit dhe Organizimit te Aktiviteteve Festive:</i> <i>Marsida Çota, e-mail: marsidacota1@gmail.com</i></p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KESHILLI BASHKIAK

<p>Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet</p>	<p><i>Draft Plani i Permiresimit te Sherbimit te Arsimit Parashkollor, Projekt Vendimi dhe Relacioni ndodhen te publikaur ne faqen e internetit të Bashkisë Librazhd, link:</i></p> <p>https://bashkialibrazhd.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Draft-Plani-i-Permiresimit-te-Sherbimit-te-Ars-Parashkollor-2025-2027-Bashkia-Librazhd.pdf</p> <p>https://bashkialibrazhd.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Relacioni-i-Planit-te-Permiresimit-te-Sherbimit-te-Arsimit-Parashkollor-2025-2027-Bashkia-Librazhd.pdf</p>
<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p><i>Këshilli siguron reagim ndaj komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve të dërguara nga publiku apo grupet e interesi për projektaktin/ projekt-politikën e shpallur për këshillim publik, përgjatë gjithë fazave të procesit të këshillimit publik.</i></p> <p><i>Në varësi të numrit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve, Këshilli, nepëmjet Sekretarit, i dërgon konfirmimin e marrjes së tyre të gjithë dërguesve: me poste elektronike (individualisht), ose me poste te rregullt, përgjigje kolektive (me poste elektronike apo në portalin e këshillimit të Këshillit; nëse postohen në portal komente apo rekomandime nga palët që kanë kontribuar, brenda 15 ditëve pune nga postimi i përgjigjes kolektive, kjo do të konsiderohet si konfirmimi i marrjes së reagimit të Këshillit nga kontribuesi).</i></p>
<p>Data e publikimit</p>	<p><i>12.11.2024 Librazhd</i> <i>Elson Malluta</i> <i>Sekretar i Keshillit Bashkiak</i></p>